



## CURRICULUM VITAE

### Prof. Dr. Esmeralda URUÇI

Prof. Dr. Esmeralda Uruci është diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë dhe në Fakultetin e Drejtësisë me rezultate të shkëlqyera. Ajo ka qenë lektore në disa universitete të vendit, Dekane e Fakultetit të Ekonomisë, Drejtore e Marrëdhënieve me Publikun në Bankën e Shqipërisë, Ministre e Kulturës, Rinisë e Sporteve e të tjerë.

Prof. Esmeralda Uruci ka kryer disa specializime dhe kërkime shkencore si në Universitetin e Padovas, Perugia-s dhe Bologna-s në Itali; në Universitetin TEI të Pireut (Greqi); në Universitetin e Ljubjanës (Slloveni); Universitetin e Nebraskës, SHBA; në shkollat pasuniversitare në Olstyn (Poloni); Bari (Itali); Athinë (Greqi) si dhe kualifikime në sistemin bankar, në Gjermani, Çeki dhe në Bankën Qendrore Evropiane.

Aktiviteti i saj pedagogjik e shkencor është i gjërë dhe i gjithanshëm. Drejton dhe merr pjesë në disa projekte kërkimore e shkencore.

Është autore e disa teksteve universitare. Botimet brenda dhe jashtë vendit përbëjnë veprimtarinë publicistike me tema që kryesisht prekin probleme ekonomike të periudhës së tranzicionit.

Aktualisht është e angazhuar si Zëvendës Dekane në Fakultetin e Ekonomisë dhe të Administrimit pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës. Gjithashtu, është e angazhuar si pedagoge jo efektive pranë Universitetit "Luigj Gurakuqi" Shkodër dhe pranë Universitetit "Zoja e Këshillit të Mirë" në Tiranë.